



Kriteret e përzgjedhjes

Kriteret e përzgjedhjes së ndërmarrjeve sociale janë zhvilluar dhe finalizuar në bashkëpunim të ngushtë me Përfituesin, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale në mënyrë që do të përdoren në procesin e vlerësimit gjatë përzgjedhjes së 10 ndërmarrjeve sociale për të cilat do të sigurohet mbështetje e specializuar gjatë periudhës zbatuese të projektit. Kriteret kryesore që një organizatë / ndërmarrje duhet t'i përmbushë në mënyrë që të kategorizohet si një ndërmarrje sociale janë përcaktuar bazuar në përkufizimin e BE-së:

- *Organizata duhet të angazhohet në veprimtari ekonomike;* që do të thotë se duhet të angazhohet në një aktivitet të vazhdueshëm të prodhimit dhe / ose këmbimit të mallrave dhe / ose shërbimeve
- *Duhet të ndjekë një qëllim të qartë dhe primar social;* qëllim nga i cili përfiton shoqëria
- *Duhet të ketë kufizime në shpërndarjen e fitimeve dhe / ose asetëve;* qëllimi i kufijve të tillë është për të përcaktuar përparësitë e qëllimit social në fitim-prurjen
- *Duhet të jetë e pavarur;* autonomia e organizatës nga shteti dhe forma të tjera tradicionale të organizatave fitimprurëse
- *Duhet të ketë një qeverisje inkluzive;* të karakterizohet nga vendimmarrja pjesëmarrëse dhe / ose demokratike

Aplikantët e pranueshëm janë ato që paraqesin një nga format e mëposhtme ligjore:

- Shoqatë që drejton veprimtari ekonomike
- Fondacion që drejton veprimtari ekonomike
- Dh.P.K. e themeluar nga një shoqatë ose fondacion
- Kooperativë
- Ofrues i shërbimeve sociale (OSHC ose kooperativë)
- Forma të tjera të organizatave që i plotësojnë pesë kriteret për ndërmarrje sociale të dhëna më sipër.

Kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimit janë si në vijim:

1. Ndryshim transformues shoqëror

Ndërmarrja sociale arrin ndryshim transformues social dhe/ose mjedisor nëpërmjet aplikimit të qasjeve inovative dhe praktike në dobi të shoqërisë në përgjithësi, me theks në popullsitë që përballen me mungesë të shërbimeve:

- a. Kandidati angazhon persona në nevojë (me aftësi të kufizuara, të papunë, me varësi, ish të burgosur, refugjatë, romë, prindër të vetëm etj.) **Min. 5- Maks. 20 pikë**
 - Dhe/ose është i përfshirë në ofrimin e shërbimeve për grupet të njerëzve në nevojë dhe / ose në çështjet mjedisore;
 - OSHC që angazhojnë¹ njerëz në nevojë në riintegrim social dhe profesional;
 - Nisma start-up me ide inovative sociale dhe afariste;

¹ Do të pranojmë gjithashtu ndërmarrje sociale që zhvillojnë veprimtari ekonomike në projekte rehabilituese, që angazhojnë pjesëmarrës në aktivitete ekonomike të riintegritimit social jo gjithmonë si punonjës me pagesë.



- b. Ndërmarrja sociale kandidate duhet të zhvillojë aktivitetin në bashkëpunim me partnerë të tjerë siç janë komunat, kompani private, OSHC etj, dhe duhet të kontribuojnë ndaj kohezionit social në komunitet përmes ndërtimit të partneriteteve lokale. – **Min.5- Maks 20 pikë**
- c. Kandidati të ketë një ide inovative p.sh. një prodhim ose shërbim të ri; një metodë të re prodhimi ose distribuimi/ programe të reja rehabilituese. Riformulimi i një produkti ekzistues për një popullsi me mungesë qasje ndaj shërbimeve; dhe / ose struktura organizative ose modele të reja të financimit. **Min.5-Maks 20 pikë**

2. Qëndrueshmëria organizative – Min 5 – Maks 20 pikë

Kandidati duhet të demonstrojë aftësinë për qëndrueshmëri financiare (burime të gjeneruara përmes shitjes së produkteve të veta, ose dhënien e shërbimeve ose ideve të mirë për të zhvilluar ndërmarrësin). Është e rëndësishme që aplikanti të demonstrojë një model biznesi dhe / ose modele aktive për reintegrimin social dhe profesional të njerëzve në nevojë.

Organizata kandidate të cilat kanë të paktën një vit përvojë pune në kohën e aplikimit të tyre duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë aktivitetet e tyre me të paktën një raport vjetor zyrtar të dorëzuar së bashku me aplikimin.

Nismat start-up janë gjithashtu të pranueshme.

3. Ndikim i dëshmuar social dhe/ose mjedisor – Vlerë e shtuar

Për këtë arsye, organizatat kandidate duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë jo vetëm aktivitetet e tyre me anë të të dhënave dhe informacioneve të arkivuara të tyre, por edhe të shpjegojnë se si ky informacion është përdorur në punën e përditshme. (Ky duhet të jetë një lloj i sistemit të garancisë, jo domosdoshmërisht zyrtar, por i brendshëm, i krijuar dhe që përdoret për të fituar rezultate sa më të mira që të jetë e mundur).

Kandidati duhet të jetë në gjendje të shpjegojë se si qasja e organizatës transformon praktikat tradicionale duke përdorur matjet e ndikimit që janë mbledhur.

4. Shtrirja dhe fushëveprimi – Vlerë e shtuar

Iniciativa sociale e ndërmarrjes është shtrirë përtej vendndodhjes së tij fillestare dhe është përshtatur me sukses në mjedise të tjera të vendit ose ndërkombëtare, qoftë nga ndërmarrësi vetë, apo nëpërmjet të tjerëve që kanë shumë ose përshtatur elementet e saj.

5. Përshtatshmëri - Vlerë e shtuar

Iniciativa ka qenë ose mund të përshtatet për vendet e tjera të rajonit, në mënyrë që të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve të ngjashme.

Kriteret 3, 4 dhe 5 mund të jenë tepër të vështira për ndërmarrjet e reja, për këtë arsye ato do të trajtohen si vlerë e shtuar në procesin e përzgjedhjes, duke mos eliminuar kështu ndërmarrjet që nuk mund t'i përmbushin.

6. Intervista – Min. 5 –Maks 20 pikë

Prezantim i shkurtër për organizatën, me paraqitje të strukturës dhe veprimtarisë. Komisioni i vlerësimit mund të paraqtojë pyetje shtesë dhe të kërkojë sqarime lidhur me pyetësin. Intervista do të zhvillohet në anglisht.



- **Nota maksimale (numri total i pikëve) për përzgjedhje është 100 pikë**
- **Të gjithë aplikuesit që kualifikohen do të ftohen për intervistë**
- **Nëse do të ketë më shumë aplikantë me të njëjtin rezultat nga kriteret 1 deri 5, paraqitja më e mirë e organizatës gjatë intervistës dhe ndikimi i saj social do të japin pikë shtesë dhe do të krijojnë vendimin përfundimtar dhe do të përcaktojnë listën përfundimtare të 10 OSHC që do të mbështeten me projektin.**